



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 1796/prot.

Tiranë, më 18.5.2022

Lënda: Kthim përgjigjeje kërkesës suaj, datë 9.5.2022.

ZNJ. D K  
"MCN TV"

E nderuar znj. K

Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, ardhur nëpërmjet postës elektronike të koordinatorit për median dhe të drejtën e informimit datë 9.5.2022, regjistruar me tonën nr. 1796 prot., datë 9.5.2022, dëshirojmë t'ju sqarojmë se:

Vendimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si rregull, marrin formë të prerë vetëm në rast se ato nuk ankimohen nga subjektet e rivlerësimit dhe/ose Komisionerët Publikë. Është Kolegji i Posaçëm i Apelit, i cili pas shqyrtimit të ankimit, del me vendim përfundimtar, që është i formës së prerë.

Lidhur me pyetjen tuaj se për sa subjekte rivlerësimi, pasi është dhënë vendimi i formës së prerë, nga viti 2019 e deri më sot, keni bërë referime në organet kompetente, ju informojmë se KPK-ja, në zbatim të ligjit, ka referuar pranë organeve kompetente 4 subjekte rivlerësimi.

Sa i takon pyetjes së dytë, ju sqarojmë se në bazë të nenit 17, pika 2/b, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", si dhe të neneve 4, pika 7, dhe 28, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, nuk mund t'ju vëmë në dispozicion këtë informacion, pasi cenon hetimin e organeve të tjera kompetente.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Edmond Verçani

